







2022

# CIKLI I MENAXHIMIT TË VULLNETARËVE

manual



# CIKLI I MENAXHIMIT TË VULLNETARËVE

manual



**Publikues:** Organizata Përtej Barrierave  
**Autor:** Eglantina Bardhi dhe Ana Mullanji  
**Editor:** Silvia Dervishi

**Adresa:** Rruga Don Bosko, Pallati Gener 2, Kati 6, H 51 Tiranë  
**Web:** [www.beyondbarriers.org](http://www.beyondbarriers.org)



**Ky projekt zbatohet në kuadër të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022 me mbështetjen financiare të Kongresit Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.**



**KONGRESI  
RINOR  
KOMBËTAR**



# përmbajtja

---

- 01 — Hyrje**
- 02 — Vullnetarizmi në celular**
- 03 — Si ta përdorni këtë manual?**
- 04 — Ta nisim nga fillimi**
- 05 — Përfitimet e Vullnetarizmit, “trekëndëshi i artë”**
- 06 — Programet vullnetare të strukturuar**
- 07 — Referencat**

# HYRJE

Vullnetarët janë një vlerë e madhe për sektorin jofitimprurës. Puna e tyre ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mbështetjen e organizatave për të arritur misionin, duke kontribuar në kapacitetin e tyre për t'i shërbyer komuniteteve dhe grupeve të synuara. Gjithashtu, vullnetarizmi ka një ndikim të vlefshëm në zhvillimin personal, profesional dhe social të atyre që zgjedhin të merren me shërbime vullnetare. Vullnetarët drejtohen nga vlerat, idealet dhe vizioni dhe në këtë kuadër, ata zgjedhin organizatat që u besojnë më shumë.

Programet e Vullnetarizmit nuk janë një domosdoshmëri për të gjitha organizatat, por ato inkurajohen ta përdorin këtë mekanizëm nëse duan të kenë udhëzime, strukturë, standarde dhe cilësi të qarta të shtuara në punën e tyre vullnetare. Kjo mënyrë sistematike e punës ka një ndikim të drejtpërdrejtë tek vetë vullnetarët, në shtrirjen e komunitetit dhe siguron cilësi në procesin e punës me vullnetarët. Kjo strukturë ndihmon gjithashtu organizatat të aftësohen dhe sigurohen që ndërtojnë programe të qëndrueshme të cilat japin dhe impakt më të madh.

Cikli i Menaxhimit të Vullnetarëve është një model, i cili fokusohet në krijimin e një strukture të qëndrueshme të angazhimit të vullnetarëve. Zbatimi i këtij modeli do të ndihmonte të gjithë ofruesit e vullnetarizmit në përmirësimin e menaxhimit të vullnetarëve dhe në krijimin e programeve vullnetare cilësore.

# “Vullnetarizmi në celular”

Projekti “Vullnetarizmi në celular” vjen si një ide origjinale e cila propozon një lehtësim të mënyrës se si veçanërisht të rinjtë por jo vetëm, mund të gjejnë mundësitë e aktiviteteve vullnetare dhe se si ofruesit e vullnetarizmit (kryesisht organizatat dhe institucionet) të kenë një pikëtakim me vullnetarët në botën dixhitale.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është krijimi i aplikacionit të parë në celular mbi vullnetarizmin në vend, si një mundësi për nxitjen dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive, solidaritetit dhe qytetarisë përmes angazhimit vullnetar.

Projekti po ashtu synon të:

- Të promovojë vullnetarizmin përmes një qasje dixhitale duke lehtësuar ndërveprimin e ofruesve të vullnetarizmit dhe vullnetarëve;
- Të nxisë dhe promovojë solidaritetin, pjesëmarrjen aktive dhe qytetarinë duke përmirësuar kushtet e vullnetarizmit në vend;

Ky projekt organizohet në kuadër të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022 me mbështetjen financiare të Kongresit Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.



Ky projekt ka 5 aktivitete kryesore:

- Zhvillimi i Aplikacionit në Celular
- Fushatë promovuese për aplikacionin dhe vlerat e vullnetarizmit përmes sesioneve informuese
- Konferenca Kombëtare e Vullnetarizmit 2.0
- Dizenjimi i Manualit ‘Cikli i Menaxhimit të Vullnetarëve’

# Si ta përdorni këtë manual?

Ky manual është një mjet pune për të gjithë organizatat dhe institucionet në Shqipëri të cilat duan të mësojnë më shumë se si mund të rrisin cilësinë e programeve vullnetare duke u bazuar në Ciklin e Menaxhimit Vullnetar. Në këtë Manual ju do të gjeni informacion të strukturuar, të përzgjedhur dhe të testuar në terrenin Shqiptar i cili ju vjen në ndihmë nëse ju dëshironi të përdorni ciklin Menaxhimit të Strukturuar të Vullnetarizmit.

Ky manual vjen si një mjet mbështetës për të gjithë punonjësit rinorë, organizatat dhe institucionet që duan t'i shtojnë vlera vullnetarizmit të strukturuar dhe u ofron atyre mjete që mund t'i përdorin për të ndërtuar këto struktura ose për të trajnuar stafin e tyre që punon ose dëshiron të punojë me programet e vullnetarizmit.

Një tjetër vlerë e shtuar e këtij manuali është që mund të përdoret më së miri si një bazë cilësore për të trajnuar punonjësit tuaj se si të planifikojnë, zhvillojnë dhe vlerësojnë angazhimin e vullnetarëve.

# Ta nisim nga fillimi ...

Duke besuar që profesionistët e kësaj fushe i njohin mirë parimet dhe gjenezën e vullnetarizmit, ne gjejmë rastin ti rikujtojmë sërish duke shpresuar që ky manual do ti shërbejë jo vetëm profesionistëve të fushës por dhe atyre që sapo nisin rrugëtimin në fushën e vullnetarizmit.

Vullnetarizmi ka tre kritere kryesore që e bëjnë atë të dallueshme nga puna apo praktika shkollore, nga aktivizmi apo pjesëmarrja në evente. Tre kriteret më poshtë janë mjaft të gjera për të përfshirë pothuajse të gjitha format e vullnetarizmit, megjithatë ato dallojnë në mënyrë efektive vullnetarizmin nga format e tjera të sjelljes që sipërfaqësisht mund t'i ngjajnë.



## **Vullnetarizmi bëhet me vullnet të lirë!**

Vullneti i lirë është parimi bazë i angazhimit vullnetar. Çdokush është i lirë të vendosë apo zgjedhë nëse do të jetë vullnetar ose jo. Në parim nuk duhet të ekzistojë asnjë kushtëzim që ta detyrojë individin të kryejë një punë vullnetare. Megjithatë, në realitet ndonjëherë personat që punojnë vullnetarisht gjenden nën presion për tu angazhuar vullnetarisht. Presioni bashkëmoshatar ose ndjenja e detyrimit shoqëror apo moral, mund të bëhen faktorë shtytës për të lëkundur vullnetin e lirë.



## Vullnetarizmi nuk bëhet për përfitime financiare!

Puna apo angazhimi vullnetar nuk ka në thelb përfitimin financiar apo pagesën për punën e bërë. Megjithatë, organizatorët duhet të sigurohen që kryerja e një pune vullnetare nuk i rëndon financiarisht individët që bëjnë vullnetarizëm. Ky aspekt është gjithashtu i rëndësishëm edhe për përfshirjen e çdokujt në vullnetarizëm. Nëse një angazhim vullnetar do të kërkonte kosto financiare të konsiderueshme si psh; pagesa e udhëtimit apo blerje e materialeve të punës, atëherë këto elementë do të ishin pengesë për pjesëmarrjen e disa shtresave me burime financiare të kufizuara.

## Sjell përfitime për një palë të tretë dhe shoqërinë në tërësi!

Ky kriter ndihmon për të dalluar vullnetarizmin nga një aktivitet i thjeshtë i kohës së lirë, siç është për shembull futbollit (megjithëse luajtja e futbollit për një qëllim të mirë mund të futet brenda përkufizimit). Kush është pala e tretë përfituese? Përfitues të punës vullnetare mund të jenë anëtarë të komunitetit ku vullnetari jeton, grupe specifike në nevojë, organizata të shoqërisë civile, institucione të caktuara, apo edhe miq apo të njohur të largët. Ata që përjashtohen nga ky koncept janë vetëm familjarët e ngushtë të personit që bën vullnetarizëm. Njëkohësisht ndihma e ndërsjellë dhe pjesëmarrja në një parti politike ose fushatë për një çështje të vetme, mund të përfaqësojnë forma vullnetarizmi që janë po aq të vlefshme sa ofrimi i shërbimeve konkrete.




# Përfitimet e Vullnetarizmit, “trekëndëshi i artë”

**VULLNETARËT**



**ORGANIZATAT**



**KOMUNITETET**



**MANUAL**

CIKLI I MENAXHIMIT TË VULLNETARËVE

# Po vullnetarët çfarë përfitojnë?

Ne nuk do të lodhemi kurrë duke renditur dhe përmendur përftimet e angazhimit vullnetar për vetë vullnetarët. Vërtet një vullnetar nuk merr një kompensim financiar ndërkohë që ofron një shërbim në komunitet, i cili e bën shoqërinë më të mirë, por vullnetarizmi është tashmë i provuar që sjell plot përfitime për këdo që angazhohet. Le të përmendim disa prej tyre, që në kohën e sotme janë dhe më të vlefshme, sidomos për të rinjtë që vullnetarizohen.

## **Vullnetarizmi ju ndihmon të pajiseni me kompetenca të reja dhe të përsosni aftësitë tuaja**

Me vullnetarizëm, njerëzit kanë mundësinë të fitojnë aftësi të reja që nuk i kanë pasur më parë. Por në të njëjtën kohë, njerëzit që angazhohen vullnetarisht përsosin aftësitë që zotërojnë. Vullnetarizmi është fusha perfekte për të marrë njohuri në çdo fushë, duke punuar me fëmijë, të moshuar, shkolla, mjedise, shëndetësi, grupe në nevojë, etj. Vullnetarizmi shërben gjithashtu për të ndryshuar pozitivisht qëndrimet ndaj grupeve të caktuara të synuara, siç janë puna me minoritetet, puna me njerëzit me aftësi të kufizuar, puna me mjedisin, etj. Vullnetarizmi ofron një ndryshim në qëndrimet e vullnetarëve ndaj fenomeneve të tilla si: diskriminimi, diversiteti kulturor, të qenit mendje hapur dhe gjithë përfshirja.

## **Vullnetarizmi është vendi i përsosur për të zhvilluar aftësi të reja**

Punëdhënësit shpesh kërkojnë individë të mirë-trajnuar që kanë aftësi të mira të punës në ekip, planifikim dhe mendim strategjik. Të qenit pjesë e një grupi vullnetarësh, një ekipi ose një bordi vullnetar është një mënyrë e shkëlqyer për të mësuar dinamikën në grup dhe punën në grup. Planifikimi dhe zbatimi i një aktiviteti të tillë si mbledhja e fondeve zhvillon aftësitë e planifikimit, të menduarit strategjik dhe aftësitë organizative.

Monitorimi dhe trajnimi i vullnetarëve i ndihmon ata të zhvillojnë aftësi për zgjidhjen e problemeve, komunikimin, negocimin, punën në ekip, aftësitë organizative, të folurit në publik, etj. Kështu që vullnetarizmi ofron mundësi të pakufizuara për të kultivuar aftësi të reja që ndikojnë në rritjen personale, profesionale dhe sociale të individit.

## **Vullnetarizmi ofron mundësi rrjetëzimi**

Vullnetarizmi në komunitetin tuaj ju mundëson të takoni njerëz të rinj nga të gjitha grupet e synuara, përfshirë edhe drejtues të komunitetit. Për të qenë vullnetar, nuk keni nevojë të jeni pjesë e një klubi rinor ose të merrni pjesë në organizata dhe struktura të veçanta. Çdokush mund të bëjë punë vullnetare duke e përshtatur atë në orarin tuaj personal. Duke bërë vullnetarizëm për grupe të ndryshme në komunitet, ju mund të zhvilloni marrëdhëniet tuaja shoqërore, profesionale dhe personale (të bëni miq të rinj), të dëgjoni për mundësi të reja pune, por edhe të krijoni referenca të shkëlqyera për punësimin tuaj në të ardhmen.

## **Vullnetarizmi ofron mundësi për të praktikuar aftësitë në një mjedis relativisht të sigurt dhe pa rreziqe.**

Me vullnetarizëm, një individ ka mundësinë të praktikojë aftësitë e tij ose të saj në praktikë. Vullnetarizmi është një vend i shkëlqyeshëm për të eksperimentuar, praktikuar dhe provuar teknika dhe aftësi të reja. Duke praktikuar, çdo vullnetar rrit aftësitë e tij ose të saj të vetëbesimit përmes praktikës dhe udhëzimeve të mbikëqyrësve/supervizorëve. Duke bërë një shërbim vullnetar, individit ka mundësinë të bashkëpunojë dhe të vëzhgojë të tjerët duke përshtatur kështu praktikat më të mira në një mjedis të sigurt dhe pa rreziqe. Këto praktika të mira kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në formimin e vullnetarit dhe sjellin një rritje të karrierës së tij në të ardhmen.

## **Vullnetarizmi ju ofron mundësi të reja karriere dhe zgjeron horizontin tuaj**

Demografia po ndryshon me shpejtësi në shoqërinë tonë dhe vullnetarizmi është një mënyrë e shkëlqyeshme për të rritur ndërgjegjësimin kulturor. Puna në ekip jo vetëm që rrit produktivitetin, por gjithashtu ofron mundësi për të mësuar më shumë rreth këndvështrimeve të ndryshme në botë. Nëse po mendoni për një ndryshim në karrierë, vullnetarizmi është një mënyrë e përsosur për të eksploruar fusha të reja. Ndonjëherë një përvojë vullnetare mund t'ju çojë në diçka që nuk e keni menduar kurrë më parë, ose ju ndihmon të zbuloni një aftësi ose interes për të cilin nuk keni qenë të vetëdijshëm më parë. Ju mund të forconi misionin dhe vizionin tuaj personal/profesional duke eksploruar mundësitë dhe duke zgjeruar horizontin tuaj.

## **Vullnetarizmi edukon qytetarët për jetën e udhëhequr nga vlerat universale**

Vullnetarizmi i edukon qytetarët të jenë aktivë në komunitetet e tyre, të jenë agjentë të ndryshimit për arsimimin dhe përfshirjen. Me vullnetarizëm, individët rrisin vetëdijen e tyre për respektimin e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit, mundësitë e barabarta, tolerancën, respektimin e diversitetit, barazinë gjinore dhe solidaritetin me grupet në nevojë.

## **Vullnetarizmi ju ndihmon të pasuroni CV-në tuaj**

Përvoja vullnetare është një përvojë pune, edhe nëse nuk paguhet. Nëse po zhvillon aftësi të reja ose po mendoni të ndiqni një karrierë të re, vullnetarizmi mund t'ju japë përvojë të vlefshme praktike. Këshilluesit e karrierës inkurajojnë punëkërkuarit të dokumentojnë përvojat përkatëse të eksperiencës vullnetare. Shkathtësitë, karakteri dhe aftësitë janë ato që kërkohen në tregun e punës sot dhe që nuk mund të merren në arsimin formal. Punëdhënësit preferojnë të punësojnë njerëz që kanë pasur përvojë vullnetare, sesa njerëz që nuk e kanë një përvojë të tillë në CV-në e tyre.



## **Vullnetarizmi ju jep kënaqësinë të përfshiheni në veprime për të përmirësuar situatën e komunitetit ose grupeve në nevojë**

Ka kaq shumë mundësi për t'u përfshirë në komunitetin tuaj, përmes shoqatave, qendrave, grupeve joformale, organizatave të lagjeve, organizatave artistike dhe historike dhe strukturave të shërbimit social. Nëse mendoni se ka diçka në të cilën mund të përfshiheni dhe të ndryshoni në komunitet, mos heshtni, organizohuni dhe përfshihuni. Bëni të tjerët të bashkohen me ju dhe së bashku të ofrojnë alternativa dhe të krijojnë zgjidhje të reja për problemet e komunitetit.

## **Vullnetarizmi krijon lidërsip**

Duke u angazhuar në punë vullnetare, individit mund të identifikojë cilësitë e udhëheqjes dhe t'i zhvillojë ato më tej. Menaxhimi i një grupi vullnetarësh nuk është i njëjtë me menaxhimin e punonjësve. Grupet vullnetare shpesh janë grupe bashkëmoshatare dhe ata i përgjigjen më shumë udhëheqjes sesa menaxhimit. Vullnetarët drejtohen nga besimet, idealet, idetë dhe inovacioni. Puna në mjediset e vullnetarëve ju ndihmon të praktikoni mendimin kritik dhe strategjik, menaxhimin e ndryshimeve dhe adaptimin, dhe aftësitë për zgjidhjen e konflikteve. Duke marrë pjesë në punë vullnetare, individit mëson për komunitetin, trendet dhe çështjet e rëndësishme, njerëzit dhe burimet ekzistuese që mund të përdoren për të mirën e komunitetit. Të gjitha sa më sipër mund t'ju ndihmojnë të zhvilloni potencialin tuaj të udhëheqjes.

## **Vullnetarizmi mund të jetë energjik, motivues dhe rinovues**

Ndonjëherë na duhet thjesht një pushim në rutinën tonë, ose një mundësi për të krijuar një ekuilibër në jetën tonë. Vullnetarizmi rreth një interesi personal ose një hobi mund të jetë argëtues, motivues, relaksues dhe energjik. Kjo energji dhe ndjenja e arritjes mund të përkthehen në një situatë pune vullnetare dhe shpesh ndihmojnë në zbutjen e tensioneve të punës dhe nxisin perspektiva të reja duke lënë pas situatat e vjetra.

# Po organizatat çfarë përfitimi kanë?

Edhe ky aspekt nuk mbetet më pas se dy të parët. Që një organizatë apo institucion të ofrojë mundësi vullnetare apo të ndërtojë programe vullnetare, duhet të shpenzojë kohë, burime financiare dhe burime njerëzore të konsiderueshme për ta bërë këtë. Veçanërisht programet vullnetare afatgjata dhe të strukturuar për të cilat do të flasim më poshtë, kanë një kosto financiare për tu dizenuar, zbatuar dhe vlerësuar. Megjithatë çdo organizatë apo institucion që përfiton nga puna e vullnetarëve përfiton në disa aspekte shumë të vlefshme.

## Vullnetarët sjellin aftësitë e nevojshme

Shumë vullnetarë sot kanë njohuri të specializuara si për shembull, zhvillimi i web-eve, programimi kompjuterik ose menaxhimi i rrjeteve sociale, që organizata juaj ka nevojë herë pas here, por jo aq shpesh sa për të punësuar dikë që të bëjë punën me kohë të plotë. Një vullnetar që dhuron aftësitë e tij ose të saj në bazë "sipas nevojës" mund të jetë plotësues i përsosur për stafin e zyrës suaj.

## Vullnetarët sjellin energji dhe risi

Edhe njerëzit më të përkushtuar mund të lodhen duke punuar në të njëjtën gjë kur e bëjnë atë 40 (ose më shumë) orë në javë. Vullnetarët janë atë që sjellin një perspektivë të re dhe entuziazëm për punën, duke i dhënë dinamikës së përditshme një rigjenerim. Kjo mund të ndihmojë në rigjallërimin e stafit dhe mund të ndihmojë në zhvillimin e projekt ideve të reja e rezultateve më të mira.

## **Vullnetarët kursejnë para!**

Në Shqipëri, por dhe në botë ka shumë organizata të cilat mbahen në këmbë tërësisht ose pjesërisht nga puna vullnetare. Duke marrë shërbimin e vullnetarëve për aspekte të ndryshme të punës së përditshme apo asaj specifike si për shembull, fushata të mëdha që kërkojnë angazhim masiv apo dhe mbajtja e rrjeteve sociale përmes një vullnetari, janë në të vërtetë një kosto e kursyer e organizatës apo institucionit. Falë punës së vullnetarëve, ka plot organizata që arrijnë të japin shërbime më të shumta dhe të vazhdueshme, me një kosto më të reduktuar. Shembull: Përtej Barrierave punon me shkollën speciale Luigj Gurakuqi prej 18 vitesh tashmë, dhe një pjesë e mirë e kësaj mbështetje që ne ofrojmë për fëmijët me aftësi të kufizuar është përmes kontributit të qindra të rinjve ndër vite që i asistojnë fëmijët çdo ditë.

## **Vullnetarët zhvillojnë angazhimin komunitar!**

Sa më shumë anëtarë të komunitetit të përfshihen në projektin tuaj, aq më lehtë do të jetë të fitoni mbështetje për punën tuaj. Gjithashtu, duke përdorur vullnetarë nga i gjithë komuniteti, mund të jeni të sigurt se qëllimet tuaja janë "në harmoni" me atë që dëshiron komuniteti, dhe jo vetëm atë që anëtarët e organizatës mendojnë se duan.



# Llojet e vullnetarizmit

Vullnetarizmi merr përmasa, forma dhe mënyra të ndryshme në varësi të disa faktorëve. Dikush ka nevojë për vullnetarë për disa ditë, dhe dikush ka nevojë për angazhim vullnetar disa muaj apo dhe vite. Në anën tjetër vete individët që duan të angazhohen vullnetarisht kanë po ashtu preferenca apo kushtëzime që i bëjnë ata të zgjedhin të jenë vullnetarë për 1 ditë, 1 muaj, 1 projekt etj. Më poshtë do të gjeni llojet e ndryshme të vullnetarizmit të shoqëruara me karakteristikat, elementët dallues, vlera, përfitime dhe tipare specifike të secilit lloj.

## Vullnetarizëm afatgjatë

- Një person që i është përkushtuar një kauze ose një grupi;
- Kane një ndjenjë të fortë përkatësie;
- Eshte investim emocional;
- Një ndjenjë e vlerës personale dhe identitetit të fituar nga pjesëmarrja;
- Një vetë-rekrutim për shkak të angazhimit ekzistues ndaj kauzës;
- Rritje personale, duke krijuar rrjetin e kontakteve dhe njohjeve me kalimin e kohës;
- Lidhje e ngushtë me grupin ekzistues të vullnetarëve;
- Menaxhim i punës, kohës dhe energjisë për gjithçka që është e nevojshme për ta bërë kauzën të ketë sukses
- Pergjithsisht, i gatshëm të bëjë çfarëdo lloj pune që kërkohet
- Motivim: çështje e arritjeve dhe përkatësisë
- Njohuri: shprehet më së miri si përfshirje ose përparim më i madh në kauzën e organizatës

## Vullnetarizëm afatshkurtër

- Interes i përgjithshëm për organizimin ose kauzën
- Përfshirja në organizatë nuk është thelbësore në jetën e personit
- Rekrutohen në mënyrë aktive përmes pjesëmarrjes në ngjarje specifike ose kërkohet nga një mik për të dalë vullnetar
- Mund të dëshirojë një punë të përcaktuar mirë me kohëzgjatje të kufizuar
- Specialist, i gatshëm / i aftë për të kryer një lloj pune
- Njohja e arritjeve personale, jo e statusit brenda grupit

## Vullnetarizëm episodik

- Kalimi nga organizata në organizatë
- Përfshirje në aktivitete vullnetare episodike
- Person që po ndryshon stilin e jetës (amvisat që hyjnë përsëri në tregun e punës, persona me aftësi të kufizuar që mësojnë aftësi të reja)
- Ndërmarrja e vullnetarizmit si aktivitet për të krijuar një rrugë kthimi në komunitet

## Vullnetarizëm kalimtar

- Personi që po ndryshon stilin e jetës (psh: një person që hyn përsëri në tregun e punës, pas një kohe të gjatë pushimi; apo dikush që ndërron tërësisht fushë punësimi dhe ka nevojë të mësojë aftësi të reja)
- Ndërmarrja e vullnetarizmit si aktivitet për të krijuar një rrugë ndërlidhje me komunitetin.

## Vullnetar i mbështetur nga punëdhënësi

- Ekzistojnë kompani që mbështesin vullnetarisht përfshirjen e punonjësve të tyre në komunitet
- Në mënyrë tipike, angazhimet vullnetare të mbështetura nga punëdhënësi janë të integruara në vendin e punës

## Vullnetarizëm profesionist

- Kur një organizatë apo institucion inkurajon stafin për të kryer punë në komunitet.
- Ndërmerret kryesisht nga individë më aftësi apo profesione specifike si mjekë, inxhinierë, juristë, specialistë IT-je etj.
- Një shembull i mirë janë “Doktorët pa kufij” ku mjekë të specializuar udhëtojnë në misione vullnetare për të ndihmuar shtresat në nevojë.

## Vullnetarizëm virtual ose dixhital

- Person që bën punë vullnetare në mënyrë virtuale ose dixhitale përmes internetit.
- Vullnetari mund të kryejë detyra afatshkurtra ose afatgjata plotësisht ose pjesërisht, në distancë nga organizata ose personi/komuniteti që ndihmohet.
- Ka marrë një zhvillim më të madh gjatë kohës së Pandemisë Covid19.
- Krijon mundësinë e përzgjedhjes së orëve apo ditëve kur do të bësh punë vullnetare pa u kushtëzuar.

# Programet vullnetare të strukturuar


Në këtë kapitull do të fokusohemi në krijimin, zbatimin dhe vlerësimin e programeve vullnetare të strukturuar. Për të ndërtuar një program vullnetar të strukturuar duhet gjithashtu një punë e mirëfilltë dhe një proces i përzgjedhur i cili të lejon të dizenjosh dhe menaxhosh programe vullnetare me impakt.

Pse duhet që organizatat të zhvillojnë programe vullnetare të strukturuar? Kjo nuk është e detyrueshme, por është e këshillueshme veçanërisht për ato organizata të cilat duan të rrisin cilësinë e punës me vullnetarët, të kenë programe të qëndrueshme, tu japin vullnetarëve një mundësi të mirëfilltë zhvillimi, të ndihmojnë në kauza apo projekte afatgjata që kanë impakt më të madh social dhe së fundmi të promovojnë vlerat dhe parimet cilësore të punës vullnetare.

Ndaj ky kapitull i këtij manuali do ti dedikohet pikërisht nevojës për zhvillimin e projekteve vullnetare të strukturuar. Për këtë ne ju propozojmë modelin e Ciklit të Menaxhimit të Vullnetarëve (CVM), të cilin Përtej Barrierave e ka testuar dhe përdorur për vite me rradhë në terrenin shqiptar dhe e kemi sjellë atë të adaptuar për organizatat Shqiptare me shpresën se do t'ju frymëzojë dhe ndihmojë të zhvilloni programet tuaja vullnetare.

# Cikli i Menaxhimit të Vullnetarëve

Cikli i Menaxhimit të Vullnetarëve është një model, i cili fokusohet në krijimin e një strukture të qëndrueshme të angazhimit të vullnetarëve. Zbatimi i këtij modeli do të ndihmonte të gjithë ofruesit e vullnetarizmit në përmirësimin e menaxhimit të vullnetarëve dhe në krijimin e programeve vullnetare cilësore.



# Faza 1.

## Analiza e nevojave

Për të analizuar nevojat, ju mund të konsideroni këto elementë:

- Misionin, vlerat dhe filozofinë e punës tuaj;
- Nevojat e target grupit lokal dhe impaktin e punës tuaj në komunitet;
- Përfshini stafin, aktivistët dhe bashkëpunëtorët në këtë proces.

# Faza 2.

## Krijimi i Programit Vullnetar

- Një program vullnetar cilësor, duhet të përmbajë këto elementë:
- Qëllimin e programit, vendin dhe kohën e zbatimit;
- Përshkrimi dhe numri i përfituesve të mbuluar nga programi;
- Numri i vullnetarëve që ju duhet për këtë program dhe profili i tyre;
- Stafin përgjegjës për programet vullnetare;
- Përshkrimin e pozicionit vullnetar dhe detyrat specifike që do të kryejë vullnetari;
- Përshkrimin e aktiviteteve mbështetëse për vullnetarin.

# Faza 3.

## Rekrutimi dhe Përzgjedhja

- Një program vullnetar cilësor, duhet të përmbajë këto elementë:
- Qëllimin e programit, vendin dhe kohën e zbatimit;
- Përshkrimi dhe numri i përfituesve të mbuluar nga programi;
- Numri i vullnetarëve që ju duhet për këtë program dhe profili i tyre;
- Stafin përgjegjës për programet vullnetare;
- Përshkrimin e pozicionit vullnetar dhe detyrat specifike që do të kryejë vullnetari;
- Përshkrimin e aktiviteteve mbështetëse për vullnetarin.

## **Faza 4.**

# **Përgatitja dhe Orientimi**

- Një vullnetar nuk duhet të nisë kurrë punën pa u përgatitur dhe orientuar më parë. Ndaj konsideroni këto elementë:
- Përgatiteni vullnetarin me informacion mbi aktivitetet, vlerat, qëllimet dhe misionin tuaj si ofrues i vullnetarizmit.
- Informojeni dhe njiheni atë me stafin, procedurat e brendshme, të drejtat dhe detyrimet e tij si vullnetar, si dhe Kodin e Etikës së Vullnetarit.
- Ofrojini vullnetarit informacion dhe orientim se ai/ajo duhet të kryejë punën.

## **Faza 5.**

# **Zbatimi i Programit**

- Gjatë fazës së zbatimit të programit vullnetar, merrni në konsideratë këto elementë:
- Delegoni një punonjës i cili mbikëqyr dhe mbështet vullnetarin në punë;
- Mbajeni vullnetarin të motivuar gjatë gjithë programit;
- Monitoroni procesin e zbatimit të programit vullnetar.

## **Faza 6.**

# **Vlerësimi dhe Njohja e Angazhimit Vullnetar**



- Për të vlerësuar programin tuaj vullnetar ju mund të përdorni këto elementë:
- Vlerësoni procesin dhe qëllimin e programit vullnetar;
- Vlerësoni rezultatet e arritura dhe impaktin në komunitet;
- Vlerësoni kontributin e vullnetarit dhe përmirësimin e kompetencave;
- Ofrojini vullnetarit mirënjohje personale dhe sociale.

# Referencat

- Ten professional development benefits of volunteering, Mary V. Merrill, LSW, Merrill Associates, July 10, 2006
- Promoting and Developing Volunteering; EFIL; Sara Borgiattino.
- Volunteer Management Handbook - Handbook for Managers; South East European Youth Network; Danijela Matorčević, Aleksandra Gligorović; (seeyn.org).







**BEYOND BARRIERS**  
PERTEJ BARRIERAVE